



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pemë dekorative për pyllëzime dhe sistemime në territorin e Bashkisë Divjakë”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 03452000-3
Pemë**

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,921,656 (katër milion e nëntëqind e njëzetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa Tvsh nga Granti

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor **Bashkia Divjakë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Konkretisht, njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 të Ligjit nr.162/2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, si edhe në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2022, 2023 dhe 2024 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, si dhe në nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar. Ky kriter, është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar “*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare*”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndërsa në pikën 2/c citohet: 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”, ndërsa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu, vendosja e kriterëve në reference, është bërë që t’i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, në nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar, në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “**Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë**” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “**Për tatimin mbi të ardhurat**” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros, Autoriteti Kontraktor është referuar në pikën 2/c, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 **“Për sistemin e taksave vendore”** i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin e fundit.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin e fundit, sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Shënim: *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi: Vendorsja e kriterit të sipërcituar, është vënë për të patur një informacion sa më koherent në lidhje me përmbushjen e detyrimeve vendore. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, nenin 40, pika 8 dhe nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar, ne Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 **“Për Sistemin e Taksave Vendore”** i ndryshuar, ne Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 **“Per procedurat tatimore”** i ndryshuar. Meqënëse, operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të vërtetojnë, se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore përkatëse, për vitin e fundit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, si edhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së përllëgaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme, argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses, sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- a) Një punësim mesatar i të paktën 5 (pesë) punonjës (duke përfshirë stafin tekniko – menaxherial), për periudhën e tre muajve të fundit nga data e shpalljes së procedurës, e dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga Administrata Tatimore.
- b) Bashkëlidhur listëpagesa e çdo muaji të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi (sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi) për periudhën e tre muajve të fundit nga data e shpalljes së procedurës.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, si edhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar. Në përcaktimin e numrit të punonjësve, specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si natyra e mallit objekt kontrate që kërkohet të furnizohet, grafiku i lëvrimit dhe kualifikimi i punonjësve (element shumë i rëndësishëm lidhur me njohuritë e tyre specifike në furnizimin në kohë të pemëve dekorative). Numri i punonjësve, kualifikimi i tyre, grafiku i lëvrimit dhe natyra e mallit objekt prokurimi, me kohështirje e tre muajve të fundit nga data e shpalljes së procedurës, tregon besueshmëri për Autoritetin Kontraktor që, operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik pjesëmarrës, e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve, është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore, e shoqëruar me listëpagesat me këtë kohështirje, është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, si një

nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim prej të paktën 5 (pesë) punonjës duke përfshirë dhe stafin tekniko-menaxherial, është në përputhje me volumin e punës, për lëvizjen e pemëve (ngarkim-shkarkim), si edhe për kujdesjen e tyre gjatë kohës së ekzekutimit të kontratës (afatit të realizimit të saj). Pra, ky kriter për kualifikim, është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve, të cilët nëpërmjet dokumentacionit, duhet të vërtetojnë se, zotërojnë kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Shënim: *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.*

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë certifikatat si mëposhtë:

Operatori ekonomik duhet paraqesë Certificate zyrtare model 3, te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe certificate origjinale të lëshuara nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF), sipas VKM Nr.523, datë 13.7.2016 **“Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese”.**

Ose

Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë furnizimi me një subjekt që duhet të jetë i pajisur me Certificate zyrtare model 3, te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit sipas modelit 4, te aneksit 4 dhe certificate origjinale të lëshuara nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF), sipas VKM Nr.523, datë 13.7.2016 **“Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese”.** Në rastin kur furnizimi do të bëhet nga një prodhues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë furnizimi nga subjekti importues, ku të jetë pajisur me këto dokumenta:

- Certificate Origjinale nga shteti importues.
- Certificate Fitosanitare nga shteti importues.
- Varietetet të jenë të regjistruara në katalogun kombëtar shqipëtar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, në nenin 40, pika 5/a, në nenin 44, pika 2 dhe 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, në Ligjin nr.10416, datë 07.04.2011 **“Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”**, si edhe në VKM Nr.523, datë 13.7.2016 **“Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese”.** Të dhënat për certifikatat e mësipërme, janë

vendosur referuar bazës ligjore për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, si dhe bazuar në aktin nënligjor normativ të nxjerrë në bazë të Ligjit nr.10416, datë 07.04.2011 **“Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”**, ku në pikën II “Kërkesat për tregtimin e materialeve të shumëzimit dhe fidanëve”, gërma “d” të VKM Nr.523, datë 13.7.2016 **“Për përcaktimin e kritereve të tregimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese”**, përcaktohet se: *“1.Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese mund të tregtohen, nëse: d) janë pajisur me certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, të lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi”*. Përsa i përket Certifikatës Fitosanitare nga shteti importues, është kërkuar pasi konfirmon pastërtinë nga sëmundje të ndryshme të bimëve.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

Çertifikatën e cilësisë ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)

Çertifikatën e cilësisë ISO 14001:2015 (Standart për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit)

(Certifikatat si më sipër, duhet të paraqiten origjinale ose kopje e noterizuar, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat që kërkohen, duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit)

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, në nenin 44, pika 1, të VKM nr.285 datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit,*, si edhe në Ligjin nr.116/2014 **“Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”**, ku përcaktohet se Çertifikatat duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që AK të krijojë sigurinë që operatorët ekonomikë ofertues, i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për realizuar me sukses kontratën. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e standartit si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe në propocion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Disponimi i ISO-s rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizojnë konkurrencën, OE duhet të paraqesin ato. Pra, për vetë natyrën e veçantë, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standartet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës, për sa kohë do të pranohen dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre, për përmbushjen e plotë të kontratës. Kjo kërkesë, është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e ofertuesit me standartet e kërkuara të cilësisë, si edhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Për sa më sipër, pajisja me këto certifikata ISO, garanton AK që OE konkurues, plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë mjetin si mëposhtë:

Mjeti	Sasia	Gjendja
Kamion me vinç	1 copë	Në pronësi ose me qera

=> Për mjetet që shënohen në regjistra publike (me goma) që janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik;
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) çertifikatë transporti.

=> Për mjetet që shënohen në regjistra publike (me goma) që janë me qera, duhet të paraqitet:

- a) kontrata e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik;
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) çertifikatë transporti.

=> Për mjetet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit.

=> Për mjetet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, por janë me qera, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, si edhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik**” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatori ekonomik pjesëmarrës, të dëshmojë që ka mjetet e nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri dhe lloji i mjeteve në pronësi/qira, është minimal, në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtësisht me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate do të transportohet nga furnizuesi në ambientin ku do të mbillen/vendosen pemët dekorative për pyllëzime dhe sisteme në territorin e Bashkisë Divjakë, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor. Mjeti i mësipërm, është i lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërben Autoritetit Kontraktor, për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Për të zbatuar kontratën, OE duhet të përmbushë kapacitetet teknike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike, operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, aftësitë organizative në përmbushje me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik**” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe

përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Pemë Pisha (Pinus Pinea)- Perimetër jo më pak se 20 cm e vazuar për më shumë se 1 vit

Pemë Hilçe (Quercus Ilex)- Perimetër jo më pak se 16 cm e vazuar për më shumë se 1 vit

Pemët dekorative (pisha dhe hilçe) kërkohen që të jenë të vazhuara për më shumë se 1 vit, për arsye të garancisë së zënies së bimës, pasi këto bimë futen te bimët delikate.

***Shënim: Në respektim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.**

***Shënim: Në kuptim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pika 3/b, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN/ISO, mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.**

Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar.

*Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/komision për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, grafikun e lëvrimit të mallit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, si edhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalentii tij/saj”. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.*

NJËSIA E PROKURIMIT